



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**A.nr.965/2015**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtare, Lirije Maksutaj dhe sekretaren juridike, Kaltrina Citaku në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Z. M. nga Fsh.T. E. KK P., kundër të paditurës, Qeveria e Kosovës-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë-Departamenti i Administratës Pensionale Prishtinë, baza juridike anulimi i aktit kontestues, në seancën e shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur ë dt.07.06.2017, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit, Z. M. ndërsa **ANULOHET** vendimi i Qeverisë së Kosovës-Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-DAP në Prishtinë, me numër të Dosjes, 6009909, i dt.16.04.2015 dhe lënda i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

### **A r s y e t i m i**

Paditësi i lartcekur si në padinë e parashtruar me dt.31.05.2015 gjykatës por edhe në fjalën e tij përfundimtare të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor, ka mbetur në tërësi si në padi dhe kërkesëpadinë që e njëjta të aprovohet si e bazuar me propozim gjykatës që të anulohet vendimi i Qeverisë së Kosovës-Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-DAP-së, në Prishtinë, me numër të dosjes, Dosjes, 56009909, i dt.16.04.2015 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim, ashtu që ti njihet kjo e drejt në pension për faktin se këtë të drejt e ka realizuar dhe me pasi konsideron s është person me aftësi të kufizuara.

Përfaqësuesja e paditurës si në përgjigjen e dhënë në padi me dt.20.04.2017 por dhe me parashtrësën e dt.05.06.2017 me të cilën e ka arsyetuar mosardhjen në seancë i ka propozuar gjykatës që meqenëse Komisionet Mjekësore kanë bërë shqyrtimin e gjithë dokumentacionit dhe kanë konstatuar se ankuesja nuk i ka plotësuar kriteret në kuptim të dispozitës 2.2 të Ligjit, nr.2003/23 për Pensionet e personave me Aftësi të Kufizuar, që të refuzoj padinë e paditëses dhe të mbetet në fuqi vendimi i kontestuar si i vendim i bazuar në ligj.

Në seancën e datës 07.06.2017 prezanton paditësi ndërsa ftesës për seancë nuk iu ka përgjigjur përfaqësuesja e të paditurës edhe pse gjykata ka dëshmi në shkresat e lëndës se është ftuar me rregull andaj, gjykata konform nenit 41 të LKA-së, seancën e ka mbajtur në mungesë të të paditurës.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor me dt.07.06.2017, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimin nr.dosje. *numri i dosjes...* dt.16.04.2015, raporte i QKUK dt.22.01.2015, raporte nga konsulta dt.10.02.2015 dt.15.01.2015, përgjigje ne padi dt.20.04.2017, vendim për PPAK dt.10.02.2015, ankesa e paditësit nr. prot.../. dt.18.03.2015, vendim për PPAK dt.22.01.2014, aporte Eko kardiografik i QKUK dt.20.01.2015, raporte ambulanca Zemra dt.16.12.2011, raporti i dt.16.12.2011, flet lëshim nr. amëze historisë se sëmundjes nr. *numri...* dt.09.08.2013, flet lëshim nga QKUK dt.04.10.2013, raporte dt.20.01.2014, dt.18.02.2015, dt.09.03.2015, dt.13.03.2015, dt.15.01.2015, formular për aplikim dt.22.01.2014, vlerësimi i komisionit mjekësore/konstatimit tij dt.01.04.2014, rivlerësimi dt.02.02.2015, rishqyrtimi i ankesave dt.02.04.2015, parashtresa e dt.05.06.2017 e shkresa tjera.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së, përgjigjen ne padi dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbaj përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se Këshilli i Ankesave me ekspert mjekësor të lëmive përkatëse, duke vepruar sipas ankesës së paditëses, në mënyrë të gjithanshme në seancën, i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor, që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë të dt.02.02.2015 në përputhje me nenin 2.2 të Ligjit PPAK, ka konstatuar se ankuesi nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzuese e pensionit me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme. Po ashtu

në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se Komisioni eksperteve mjekësor nga shkalla e dytë, në seancën mjekësore, ka vlerësuar komplet dokumentacionin mjekësor dhe për bazë ka marrë certifikatën e mjekësisë familjare të licencuar, dokumentacionin mjekësor si dhe raportet nga specialistet dhe është konstatuar se ankuesja nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbushur kriteret, për të qenë shfrytëzuese e pensionit me aftësi të kufizuara të plotë dhe e përhershme, siç përcaktohet me Ligjin 2003/23, me ç ‘rast bazuar në këtë vlerësim organi administrativ në shkallë të dytë e refuzon ankesën si të pabazuar dhe vërteton vendimin e shkallës së parë.

Duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar me padi dhe pas administrimit të prova gjykata gjen se paditëses i është refuzuar kërkesa respektivisht ankesa për Pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuara, vetëm me konstatimin se, refuzimi i kërkesës është “bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtruesit të kërkesës dhe ka konstatuar se tek i njëjta aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme nuk ekziston”.

Mirëpo nga vendimi i të paditurës dt.22.01.2014 shihet se paditësi e ka realizuar këtë pension për shkak të aftësive të kufizuara për periudhën një vjeçare ndërsa me vendimin kontestues i është mohuar kjo e drejtë nga e paditura, me konstatimin se arsye e refuzimit të kërkesës, respektivisht ankesës është “ bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësor, i cili ka vlerësuar se të ankuesi aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme nuk ekziston”.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i padituri, nuk ka bërë fare arsyetim në vendimin e saj, se nga cila bazë paditëses i është rikthyer aftësia e plotë dhe e përhershme, kur nga vet vlerësimi i Komisionit mjekësor të mëparshme është konstatuar se paditësi është person me aftësi të kufizuara andaj, në këtë kuptim për këtë gjykata nuk është e çartë se si Komisioni Mjekësor me dt.02.04.2015 ka ardhur deri të përfundimi se gjendja e paditësit të këtë ndryshuar ashtu që nuk e ka paaftësinë respektivisht se ka pushuar se ekzistuari paaftësia e plotë dhe e përhershme dhe nuk i plotëson kushtet ligjore për t`iu njohur e drejta në pension. Kjo dhe për faktin se lidhur me këtë çështje nuk është dhënë asnjë arsyetim as nga Komisioni Mjekësorë as në aktvendimin e atakuar të paditurës. Andaj, në këtë gjendje të çështjes të konstatuar nuk është e çartë se mbi çfarë baze Komisioni Mjekësor ka konstatuar se paditësi nuk e ka paaftësinë ashtu që qëndrimi i Komisionit mjekësor është në kundërshtim të plotë me provat që gjinden në shkresat e lëndës dhe deklaratimet e paditësit ne seancë.

Kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendimet e të paditurës në si përgjigjën në padi se aktvendimi kontestues është i bazuar në ligj sepse ankuesja para Komisionit Mjekësorë nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se i plotëson kriteret e përcaktuara mirëpo si të tilla nuk i aprovoj për faktin se njëjta nuk ka arritur të dëshmoj me fakte dhe prova një gjendje tjetër nga ajo që pretendon paditësja.

Meqenëse kjo gjykatë në konfliktin administrativ vendosë mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, në rastin konkret nga vendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar kjo gjendja faktike.

Kjo gjykatë konstaton se të metat e cekura si më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë në afat prej 30 ditësh të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoi të metat e lart cekura të merr aktvendim të drejtë e të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 41 paragraf.2, 43, 46.2, 3 e lidhur me nenet 5, 6, 38 dhe nenin 64 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr. me dt.965/15 dt.07.06.2017

Sekretare Juridike  
Kaltrina Citaku

G j y q t a r e  
Lirije Maksutaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.